



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 6
22.12.2016

NR. VENDIMI 4
01.02.2017

V E N D I M
“PËR REVOKIM TË SEKUESTROS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej :

GJYQTAR : DRITAN HALLUNAJ

me sekretare të seancës gjyqësore **Ankela DAKE**, mori në shqyrtim sot me **dt. 01.02.2017** në seancë kërkesën për revokim të sekuestros, me Nr. 6/33 Akti, të vitit 2016, që i përket:

Kërkues:

F.E(alias E.K), i dtl. xx.xx.xxxx, lindur në xxxxx dhe banues në xxxxxx, Lagjia xxxxxx xxxxxx”, përfaqësuar në këtë gjykim me prokurën e posaçme me Nr. 379 Rep. 124/1 Kol. datë 26.01.2017, nga **avokati S. V.** , i cili është anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Persona të tretë:

1. A.K, e bija e A.-it, e dtl. xx.xx.xxxx, lindur në xxxxx dhe banuese në xxxxx, përfaqësuar në këtë gjykim (**në mungesë të saj**) me prokurën e posaçme me Nr. 199 Rep. 95 Kol. datë 19.01.2016, nga **avokati S. V. a**, i cili është anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

2. A.K, i dtl. xx.xx.xxxx, xxxxx dhe banuese në xxxxx, përfaqësuar në këtë gjykim (**në mungesë të tij**) me prokurën e posaçme me Nr. 199 Rep. 95 Kol. datë 19.01.2016, nga **avokati S. V.** , i cili është anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë

3. E.XH, banuese në

Fier, Rr. "XXXXXXXXXXXXXXXXXX".

4. E.XH, i identifikuar para gjykatës me letërnjoftimin ID XXXXXXXXXXXX.

Palë e interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar nga prokurorja **D. M.** .

Objekti: **Revokimin e vendimit nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, "Për sekuestrimin e pasurive" konkretisht:**

- a. Pasuria me nr. x/XXX+x-XX, në zonën kadastrale XXXX Vol. XX, fq.XXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen "XXXXXXXXXXXXXXXXXX", Fier, e cila figuron në emër të shtetasve A dhe A.K.
- b. Pasuria me nr. x/XXX+x-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen "X XXXX", Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007.

Baza Ligjore: Neni 275/1 i K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën në tërësi;

Dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit F.E(alias E.K) dhe të personave të tretë A.K dhe A.K, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj;

Dëgjoi personalisht personin e tretë E.XH, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj;

Personi i tretë E.XH në mungesë;

Dëgjoi prokuroren, e cila përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj;

Pasi u njoh me provat e administruara në këtë gjykim, si dhe pasi u konsultua me ligjin,

V Ë R E N:

Pranë kësaj gjykate, ka paraqitur një kërkesë kërkuar F.E(alias E.K), i cili ka thirrur edhe si persona të tretë shtetasit A.K, A.K, E.XH dhe E.XH, sipas së cilës kërkon Revokimin e

vendimit nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për “Vendosjen e sekuestros” mbi dy pasuritë që janë cituar në këtë vendim.

Gjykata, thirri në gjykim si palë të interesuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, pasi mbi bazën e kërkesës së kësaj prokurorie, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë ka vendosur sekuestron sipas vendimit nr. 28 datë 23.12.2015, për pasurinë me nr. X/XXX+x-XX, në zonën kadastrale XXXX Vol. xx, fq.xxx, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen “XXXXXXXXXXXXXXXXX”, Fier, e cila figuron në emër të shtetasve A. dhe A.K dhe për pasurinë me nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen “X XXXX”, Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007.

Fillimisht, kërkuesi E. (alias E.K), i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objekt “Revokimin e vendimit nr. 1 datë 10.01.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për “Vendosjen e sekuestros preventive” mbi pasuritë që citohen në këtë vendim. Gjatë gjykimit, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij me prokurë, i cili është përfaqësues edhe i personave të tretë, kërkoi ndryshimin e objektit të kërkesës, duke kërkuar revokimin e vendimit nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për “Vendosjen e sekuestros” mbi pasuritë që citohen në këtë vendim.

Në këto kushte, gjykata, bazuar në nenin 185/1 të K.Pr.Civile, vendosi të pranojë kërkesën e bërë nga përfaqësuesi i palës kërkuese dhe personave të tretë që gjykohen në mungesë, për ndryshimin e objektit të kësaj kërkesë, duke shqyrtuar si objekt në këtë gjykim, atë të revokimit të vendimit nr. 28 datë 23.12.2015 “Për sekuestrimin e pasurive”.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në datë 10.07.2014, ka regjistruar procedimin penal nr. 209, në ngarkim të shtetasit nën hetim F. E. , i dyshuar për veprën penale të “Trafikimit të femrave”, parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal.

Në bazë të akteve të këtij procedimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, **me datë 05.01.2015 ka regjistruar procedimin pasuror nr. 1**, në ngarkim të shtetasve F. E. , A.K, A.K, E.XH dhe E.XH.

Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, **me vendimin nr. 1 datë 10.01.2015**, është vendosur sekuestro preventive mbi pasurinë me nr. X/XXX+X-XX, në zonën kadastrale XXXX Vol. XX, fq.XXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen “XXXXXXXXXXXXXXXXX”, Fier, e cila figuron në emër të shtetasve

A. dhe A.K dhe për pasurinë me nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen “X XXXX”, Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007.

Në datën 24.07.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka shpallur moskompetencën e këtij procedimi penal dhe ka vendosur kalimin e akteve të këtij procedimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, për veprat penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 114 dhe 287 të Kodit Penal.

Në vijim, bazuar në ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, **me vendimin nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë**, është vendosur:

“Sekuestrimi i pasurive të mëposhtme:

1. *Pasuria me nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, Vol XX, fq.XXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen ‘XXXXXXXXXXXXXXXX’, Fier, e cila figuron në emër të shtetasve A. dhe A.K.*
 2. *Pasuria me nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen ‘X XXXX’ Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007.*
- *Pezullimi i pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit sipas këtij ligji, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin ose shuarjen e kësaj mase”.*

Sipas deklarimeve të përfaqësuesit të kërkuesit dhe personave të tretë në këtë gjykim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat dërgoi çështjen për gjykim me akuzat e parashikuara nga nenet 114 dhe 287 të Kodit Penal dhe në përfundim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit F.E dhe dënimin e tij sipas dispozitave në fuqi.

Nga ana e të pandehurit është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila e ka deklaruar fajtor të pandehurin F.E për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të krimit”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Heqjen e sekuestros preventive mbi dy pasuritë e sekuestruara sipas procesverbalit t'i kthehen të pandehurit.

Ndërkohë, **me vendimin e datës 05.12.2016 “Për pushimin e procedimit pasuror”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë** ka pushuar procedimin pasuror me nr. 1 të vitit 2015.

Në këto kushte, duke qenë se është pushuar procedimi pasuror në ngarkim të shtetasve F.E(alias E.K), A.K, A.K, E.XH dhe E.XH, përfaqësuesi i kërkuesit F.E dhe i personave të tretë A.K, A.K, E.XH, si dhe vetë personi i tretë E.XH i cili ishte vetë

prezent në seancë, kërkuan revokimin e vendimit nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me anë të të cilit është vendosur sekuestroja e dy pasurive që citohen në këtë vendim.

Gjykata, dëgjoji edhe mendimin e përfaqësueses të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e cila u shpreh dakort me kërkesën e paraqitur nga ana e kërkuesit F.E (alias E.K) dhe kërkoi që të pranohet nga gjykata.

Kërkesës për revokimin e sekuestros, pala kërkuese i bashkangjiti edhe provat e mëposhtme, të cilat u administruan nga gjykata dhe u bënë pjesë e fashikullit të gjykimit:

- Vendim i datës 05.12.2016 “Për pushimin e procedimit penal pasuror nr. 01/2014” i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- Vendimi nr. 28 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- Vendimi nr. 1 datë 10.01.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjykata, në këto kushte, çmon se kërkesa e paraqitur nga ana e kërkuesit F.E (alias E.K), duhet të pranohet, si e bazuar në ligj dhe në prova.

I. Nga aktet në dosje, me vendimin e datës 05.12.2016 “Për pushimin e procedimit pasuror”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë ka pushuar procedimin pasuror me nr. 1 të vitit 2015, në këto kushte, gjykata çmon që rjedhimisht edhe sekuestroja e vendosur mbi pasuritë objekt i këtij procedimi pasuror nuk ka më fuqi dhe për këtë arsye duhet të revokohet.

Sipas vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë të datës 05.12.2016 “Për pushimin e procedimit pasuror”, nga hetimet pasurore që janë kryer në vijim, mbas marrjes së vendimit të sekuestrimit nr. 28 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk është provuar se dy pasuritë e sekuestruara janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe për këtë arsye prokurorja ka çmuar se nuk duhet t`i nënshtrohen konfiskimit.

Lidhur me pasurinë nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen “X XXXX” Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007 dhe është blerë prej E. dhe E.XH, nga hetimi i kryer, nuk ka rezultuar që kjo pasuri është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të shtetasit F. E. . Personi i tretë

E.XH, e cila me gjëndje civile është ndarë nga familja e saj biologjike, është e martuar me personin e tretë E.XH dhe nga hetimi që është bërë në lidhje me të ardhurat e tyre (kursime apo kredi), ato justifikojnë vlerën e blerjes së shtëpisë së tyre.

Lidhur me pasurinë nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, Vol XX, fq.XXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen “XXXXXXXXXXXXXXXXXX”, Fier, e cila figuron në emër të shtetasve A. dhe A.K, nga hetimi i kryer, nuk ka rezultuar që kjo pasuri ka prejardhje të paligjshme, pasi nuk u provua se është blerë pikërisht me paratë e përfituara prej të hetuarit F.E. krimi i shfrytëzimit të prostitucionit. Nga hetimi që është bërë në lidhje me të ardhurat e personave të tretë A.K dhe A.K (kursime apo kredi), ato justifikojnë vlerën e këtij apartamenti.

Pra në këto kushte, duke iu referuar këtij vendimi pushimi, gjykata, konstaton se nuk plotësohen kriteret e parashikuara nga ligji nr. 10192 datë 03.12.2009, **neni 11 i tij**, që në rastin konkret të vijojë të jetë në fuqi masa e sekuestros, për arsye se:

- Procedimi pasuror nr. 1 i vitit 2015, i cili ka në objektin e tij dy pasuritë e sekuestruara me vendimin nr. 28 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është pushuar nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, sepse nga hetimet pasurore të kryera në vijim, nuk është provuar se dy pasuritë e sekuestruara janë krijuar në mënyrë të paligjshme. Megjithëse kjo gjykatë, po mbi bazën e nenit 11 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 ka vendosur sekuestrimin e këtyre pasurive, vihet në dijeni gjatë këtij gjykimi se nga hetimet pasurore të mëtejshme, nuk ekzistojnë kriteret që parashikon ky ligj për të vijuar masën e sekuestros së dhënë.
- Ndaj të pandehurit F.E (alias E.K) është pushuar vepra penale e “Pastrimit të produkteve të krimit”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe në këto kushte *“nuk ekziston më dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregon se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave të tij...”*.

II. Ndërsa, në lidhje me masën pezulluese për të cilën gjykata është shprehur në vendimin nr. 28 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, **neni 5 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009** citon si më poshtë:

*“Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. **Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave**”.*

Pra në kushtet kur me vendimin nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës

së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është vendosur edhe pezullimi i pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin ose shuarjen e kësaj mase, gjykata, çmon që edhe kjo masë pezulluese përfundon me revokimin e vendimit të sekuestrimit për dy pasuritë e cituara në vendimin nr. 28 datë 23.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenin 5, 11 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”

V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi F.E (alias E.K).
- Revokimin e vendimit nr. 28 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë “Për sekuestrimin e pasurive”, konkretisht:
 - Pasurinë më nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, Vol XX, fq.XXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe totale 117 m², pasuri e ndodhur në lagjen ‘XXXXXXXXXXXXXXXXXX’, Fier, e cila figuron në emër të shtetasve A. dhe A.K;
 - Pasurinë me nr. X/XXX+X-XX, e ndodhur në zonën kadastrale XXXX, e cilësuar si apartament me sipërfaqe 100.7 m², e ndodhur në lagjen “X XXXX” Fier, e cila figuron në emër të firmës ndërtuese XX-XX 2007.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor, Fier.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë. Për palët e interesuara në mungesë, afati fillon me marrjen dijeni.
- **U shpall sot në Tiranë, me datë 01.02.2017.**

SEKRETARE

GJYQTAR

ANKELA DAKE

DRITAN HALLUNAJ

